

**STRATEGJIA PËR GRATË NDËRMARRËSE
NË KOMUNËN E KAMENICËS PËR PERIUDHËN 2017-
2022**

Përgatitur nga:

Nazmi Pllana

Kosovo Center for Business Support

Tetor 2016

Prishtinë

Përmbajtja e Strategjisë për Femrat Ndërmarrëse në Komunën e Kamenicës për Periudhën 2017 – 2022 është përgjegjësi e KCBS dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e USAID apo Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.



Strategjia për Gratë Ndërmarrëse në Komunën e Kamenicës për Periudhën 2017 – 2022 është produkt i projektit “Ta ndryshojmë Kosovën duke Fuqizuar Gruan” në kuadër të programit Angazhimi për Barazi, i financuar nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID, mbikëqyrur nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC dhe implementuar nga Kosovo Center for Business Support – KCBS.

1. BAZA E PROBLEMIT

Edhe pse viteve të fundit Republika e Kosovës ka shtuar përpjekjet në promovimin dhe avancimin e barazisë dhe mos diskriminimit, e në veçanti avancimin e pozitës së gruas, megjithatë vazhdon të përballet me shumë sfida sa i përket shfrytëzimit të plotë të potencialit të grave në tregun e punës dhe në ekonomi në përgjithësi.

Edhe pse barazia gjinore, garantimi i të drejtave dhe mundësive të barabarta është aspekt fundamental i qeverisjes, i garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjet në fuqi, megjithatë, në praktikë është shumë më sfiduese për femrat që t'i gëzojnë dhe t'i ushtrojnë këto të drejta. Niveli i pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje dhe pozita e tyre në shoqëri varet kryesisht nga pozita ekonomike që ato kanë. Raportet dhe studimet e publikuara nga organizata ndërkombëtare dhe lokale flasin për numër simbolik të grave që janë pronare në biznes, me vetëm 15%-17% në nivel vendi. Të dhënat tregojnë se pavarësisht politikave dhe legjislacionit të miratuar në nivel nacional, përmirësimi i pozitës së gruas, fuqizimi dhe motivimi i tyre për t'u marrë me biznes nuk mund të sigurohet pa krijimin e politikave lokale, të cilat duhet të krijohen dhe miratohen nga vetë komunat sipas specifikave që kanë.

Sipas raportit të Bankës Botërore, bizneset e grave në Kosovë kryesisht janë krijuar nga nevoja për të siguruar mirëqenien e familjeve të tyre për dallim nga bizneset e grave në Evropë dhe Azinë Qendrore (EAQ), ku për së paku 50% të arsyeja e krijimit është mundësia për zhvillim¹.

Sipas një raporti të Bankës Botërore, në fushën e ndërmarrësisë, prezenca e gruas është shumë e vogël (rreth 11%) në krahasim me mesataren e vendeve të rajonit (rreth 33%) dhe mesataren e globale (rreth 38%). Në Kosovë deri në fund të vitit 2013, janë regjistruar mbi 128,000 biznese, prej të cilave vetëm 11.04%, ose 14,168 biznese janë në pronësi të grave, tetë herë më pak se bizneset në pronësi të burrave - 114,173.

Raporti i Bankës Botërore "Të bërit biznes" i vitit 2014 identifikon Kosovën si një prej 10 shteteve më të mira reformuese në vitin 2013, me reforma të realizuara në 3 nga 10 tregues të të bërit biznes (hapja e biznesit, marrja e lejeve të ndërtimit dhe regjistrimi i pronës)² duke e përmirësuar efektivisht rangimin e Kosovës nga vendi i 96-të në 2013 në vendin e 86-të në 2014. Sidoqoftë, Kosova vazhdon të jetë e pllakosur në ekonomi të dobët, papunësi e varfëri të madhe. Nga këndvështrimi gjinor, gjendja ekonomike e tanishme shpalosë hendeqe të mëdha gjinore në një varg faktorësh që kontribuojnë në rritje ekonomike: punësimi, udhëheqja, pronësia e biznesit dhe qasja në financa.

Studimi i fuqisë punëtore të Kosovës në 2012 ka nxjerrë disa statistika që flasin mjaft për hendekun gjinor në punësim, duke përfshirë:

- Më pak se një në pesë (17.8%) femra në moshë pune janë aktive në tregun e punës, krahasuar me më shumë se gjysmën e meshkujve (55.4%) në moshë pune;
- Në mesin e fuqisë punëtore, papunësia është shumë më e madhe të femrat sesa meshkujt (40.0% krahasuar me 28.1%); dhe
- Shkalla e punësimit të femrave në moshë pune është vetëm 10.7% krahasuar me 39.9% për meshkujt.

¹ Banka Botërore. Dallimet Gjinore: Arsim, Shëndetësi dhe Mundësitë Ekonomike. Prishtinë: Banka Botërore, 2012

Mosprania e femrave në tregun e punës është rrjedhojë e kushteve joadekuate të punës (për shembull, nuk ka orar fleksibil të punës) dhe faktit se punëdhënësit shfaqin rezerva kur bëhet fjalë për punësimin e femrave të reja, të cilat janë në moshën për t'u bërë nënë, duke u nisur nga pushimi i gjatë i lehonisë i paraparë me Ligjin e punës të Kosovës, barra e kostos së të cilit sipas ligj bie më së shumti mbi punëdhënësit. Veç kësaj, qasja e femrave në punësim pengohet edhe nga shpalljet diskriminuese për vende pune që mund të përcaktojnë se “femrat të cilat aplikojnë të mos jenë mbi moshën 30 vjeçare.”

Femrat kosovare përbëjnë vetëm 0.3% të menaxherëve të lartë nëpër kompanitë private, përqindje kjo ndër më të ulëtat në vendet e Evropës dhe Azisë Qendrore, ku femrat përbëjnë mesatarisht 20% të menaxherëve të kompanive. Një studim i Odës Ekonomike të Kosovës në vitin 2012 i femrave në pozita vendimmarrëse në sektorët publik dhe privat ka gjetur se nga 71 kompani private (kryesisht ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM)) që përfaqësonin katër sektorë (TIK, turizmi, bujqësia dhe financat), femrave u ishte besuar vetëm një mesatare prej 4.2% e pozitave vendimmarrëse.

Rezultatet e anketimit të prezantuara në raportin e vitit 2014 “Femrat dhe biznesi: Barazia gjinore në biznes” përgatitur nga projekti Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial (CLE) dhe financiar nga USAID kanë dalë disa nga këto përfundime: shumica e personave të anketuar besojnë se të dy gjinitë kanë qasje të barabartë në mundësitë për punësim, dhe se si meshkujt ashtu edhe femrat mund të jenë njëlloj efektivë si udhëheqës biznesi. Pengesat kryesore për pjesëmarrjen e femrave në biznes që janë përmendur në këtë raport janë: përgjegjësitë e posaçme të femrës ndaj familjes, mungesa e mbështetjes së nevojshme për biznes siç është mungesa e traditës së femrës që bën biznes, mungesa e ndihmës shtetërore, mundësitë më të vogla për përkrahje financiare nga bankat dhe çështja e pronësisë, përkatësisht çështja e trashëgimisë për femrat.

Të dhënat e raportit “Femrat, biznesi dhe ligji 2014” të Bankës Botërore për vitin 2013, që vlerëson dallimet përballë ligjit midis meshkujve dhe femrave në këto kategori: qasjen në institucione, shfrytëzimin e pronës, gjetjen e vendit të punës, ofrimin e lehtësirave për punë, historikun e mirë të huamarrjes, shkuarjen në gjykatë, si dhe mbrojtjen e femrave nga dhuna, ka gjetur se 10 nga 143 vendet që kanë qenë pjesë e studimit, përfshirë Kosovën, nuk bënë asnjë dallim gjinor në aspektin juridik.

Në pozitë veçanërisht të pafavorshme ndodhen femrat ndërmarrëse në zonat rurale. Një studim i bërë në vitin 2006 tregon se shumica e femrave ndërmarrëse “bëjnë biznes nga shtëpitë e tyre, më pak se 5 për qind udhëtojnë jashtë fshatit për të shkuar në punë, 77 për qind ua lënë në dorë gjithë vendimet e rëndësishme për biznesin anëtarëve meshkuj të familjes, dhe vetëm 13 për qind kanë deklaruar që jetojnë kryesisht nga të ardhurat e tyre personale.” Lënia e vendimmarrjes në duart e bashkëshortit, bijve ose vëllezërve nuk është diçka e pazakontë për femrat ndërmarrëse kosovare. Në një anketë me 1,450 femra të cilat janë pronare biznesi, 25% të atyre që janë bashkëpronare në biznes kanë raportuar se nuk marrin vendime për biznesin e tyre dhe se shumë prej tyre vendimmarrjen ua kanë lënë në dorë bashkëshortëve (50%) dhe vëllezërve (20%).

2. DOKUMENTET BAZË

Bazë për hartimin e kësaj strategjie kanë shërbyer: dokumenti Strategjia Kombëtare për Zhvillim Ekonomik 2016-2020, Plani Zhvillimor i komunës së Kamenicës 2013-2023, përfundimet e dala nga takimet me Rrjetin joformal të grave të komunës së Kamenicës, përfundimet e dala nga takimet e Grupit të përbashkët punues komunë-shoqëri civile për zhvillimin e strategjisë, si dhe debati në punëtorinë e organizuar nga Qendra Kosovare për Përkrahje të Biznesit (KCBS)

Strategjia Kombëtare për Zhvillim Ekonomik 2016-2020²

Në janar të këtij viti, qeveria e Kosovës miratoi Strategjinë Kombëtare për Zhvillim Ekonomik 2016-2021. Qëllimi i kësaj strategjie është që t'i adresojë pengesat kryesore për zhvillimin e Kosovës dhe të caktojë një listë të prioriteteve të larta për zhvillim.

Përzgjedhja e prioriteteve dhe masave të SKZH është bërë duke u bazuar në dy parime të përgjithshme. Parimi i parë është nevoja për të siguruar norma vjetore më të larta të rritjes ekonomike. Kjo nënkupton nevojën për rritjen e të ardhurave, e për rrjedhojë edhe të punësimit dhe të mirëqenies për qytetarët e Kosovës. Parimi i dytë është nevoja që paralelisht me rritjen ekonomike të sigurohet edhe kohezion shoqëror dhe gjithëpërfshirje, gjë që nënkupton mospërrjashtimin e grupeve të caktuara të shoqërisë nga përfitimet e rritjes ekonomike. Gjithëpërfshirja është e domosdoshme jo vetëm për shkak se është parakusht për drejtësi shoqërore dhe kohezion, por edhe për shkak se si e tillë ajo mundëson rritje më të madhe dhe më të qëndrueshme ekonomike.

Strukturalisht, Strategjia është e ndarë në katër shtylla tematike: kapitali njerëzor, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë, zhvillimi i industrive konkurruese, si dhe zhvillimi i infrastrukturës.

Prandaj, në pesë vitet e ardhshme, Strategjia synon që të orientojë politikën në drejtim të kthimit të fuqisë punëtore të Kosovës në motor të zhvillimit. Këtë do ta bëjë duke i adresuar mangësitë e sistemit arsimor si dhe duke e shfrytëzuar kapitalin njerëzor të diasporës për transferim të njohurive. Investimet në kapitalin njerëzor do të japin rezultatet e tyre në fazë të mëvonshme, por kthimi në investime është i sigurt.

Për këto arsye, Strategjia synon që të rris përkrahjen e shtetit për biznese dhe për të mirën e qytetarëve, në mënyrë që të stimulohen investimet dhe kështu të mundësohet rritje më e lartë ekonomike dhe trajtim të barabartë të të gjithë qytetarëve para institucioneve të shtetit. Për këtë arsye, janë paraparë masa që do të synojnë forcimin e sistemit të të drejtave pronësore dhe do ta përshpejtojnë zgjidhjen e rasteve nga ana e gjykatave.

Për këto arsye, Strategjia H synon që të rris përkrahjen e shtetit për procesin e ri-industrializimit në Kosovë, në mënyrë që ndërmarrjet tona private dhe publike të mund të rriten dhe të kalojnë në aktivitete me vlerë të shtuar më të lartë dhe të prodhojnë mallra të tregtueshme apo shërbime për eksport. Kjo do të thotë, mes tjerash, krijimin e lehtësirave dhe ofrimin e stimulave për investitorët strategjikë dhe për projekte dhe nisma që e rrisin konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve, sidomos për arritjen e standardeve të cilësisë për eksport.

² Qeveria e Kosovës. Strategjia Kombëtare për Zhvillim Ekonomik 2016-2020. Prishtinë, 2016

Për këto arsye, Strategjia synon që t'i orientojë resurset financiare të shtetit drejt ndërtimit të asetëve strategjike të infrastrukturës të cilat do të jenë në funksion të zhvillimit. Në sektorin e energjisë, çështja e sigurisë së furnizimit do të adresohet përmes ndërtimit të kapaciteteve të reja të bazuara në linjit, ndërkohë që do të shqyrtohen mundësitë për përdorimin e burimeve të ripërtërishme nga uji dhe biogasi.

Plani Zhvillimor i komunës së Kamenicës 2013-2023³

Qëllimi kryesor i këtij projekti është që Komuna e Kamenicës të ketë një Plan Zhvillimor Komunal real dhe të zbatueshëm por edhe modern, efikas dhe të bazuar në norma e standarde evropiane. Ky projekt do të jetë në harmoni të plotë me kërkesat dhe obligimet e Ligjit për Planifikim Hapësinor 2003/14 dhe Ligji për ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor L-03/L-106 si dhe në pajtueshmëri me Draft Planin Hapësinor të Kosovës. Plani Zhvillimor Komunal do të sigurojë bazat për një zhvillim të qëndrueshëm për qytetin e Kamenicës, pra duke krijuar bazat për:

- Shfrytëzim racional, mbrojtje dhe rregullimi të hapësirës së komunes;
- Ruajtja e vlerave natyrore dhe vlerave të krijuara me punë;
- Realizim të planifikimit hapësinor me përgatitjen e bazave për nxjerrjen e planeve të niveleve më të ulëta;
- Rregullim i hapësirës duke ua përshtatur hapësirën nevojave;
- Nxjerrjes së planit si plan afatgjatë të zhvillimit hapësinor dhe harmonizimi i ndërsjellë i këtij plani, duke u nisur nga parimet e planifikimit të njëkohshëm dhe të vazhduar me dokumentet e nivelit qendror;
- Përgatitjes dhe nxjerrjes së planit sipas mënyrës dhe procedurës së caktuar me ligj;
- Pjesëmarrjes së të gjithë shfrytëzuesve të hapësirës në procesin e përcaktimit të politikës së organizimit, rregullimit dhe shfrytëzimit të hapësirës.

Me këtë strategji Komuna ka katër prioritete strategjike:

- Demografia dhe Çështjet Sociale
- Zhvillimi Ekonomik
- Mjedisi dhe Shfrytëzimi i Tokës (planifikimi dhe menaxhimi i vendbanimeve) dhe
- Infrastruktura

Komuna e Kamenicës shtrihet në lindje të Kosovës. Kufizohet në jugperëndim me Komunën e Ranillugut, në perëndim me komunën Novobërdës, në veriperëndim me Prishtinën, në veri me Komunën e Medvegjës dhe Leskocit, në lindje me Vranjën, si dhe në lindje e juglindje me Bujanocin. Sipërfaqja e komunës është 417 km². Pozita gjeografike e komunës është periferike dhe në skajin me lindor të Kosovës, por është urë lidhëse në mes të Kosovës dhe komunave të Serbisë Jugore, kryesisht të banuara me shqiptarë. Përmes magjistrales Gjilan -Bujanoc, lidhet me qendrat tjera të Kosovës. Gjilani ndodhet në largësi prej 30 km, ndërsa Prishtina është larg 75 km nga Kamenica.

Ne vitin 2011, kur është bërë regjistrimi i popullsisë në nivel të Kosovës, komuna e Kamenicës kishte 36,085 banorë ose 2.1% të popullsisë totale të Kosovës. Prej këtij numri 18,559 ishin meshkuj ose 51.4%

³ Komuna e Kamenicës. Plani Zhvillimor i komunës së Kamenicës 2013-2023. Kamenicë, 2013

kurse 17,526 ishin femra ose 48.6%. Vetëm 7,331 persona jetojnë në qytet ose 20.3%, kurse pjesa tjetër prej 28,754 ose 79.7% të personave jetojnë në fshatra. Nga popullsia e aftë për punë e që gjithsej janë 24,268 persona, 12,547 ose 51.7% ishin meshkuj në vitin 2011, kurse 11,721 ose 48.3% ishin femra.

Komuna	Popullsia			Foshnje 0 vjeç	Fëmijë 1-6	Fëmijë 7-14	Rinia 15- 27	Popullsia e aftë për punë 15-64			65+
	Gjithsej	Meshkuj	Femra					Gjithsej	Meshkuj	Femra	
Gjithsej	36,085	18,559	17,526	508	3,058	5,334	8,776	24,268	12,547	11,721	2,917
		51.4%	48.6%	1.4%	8.5%	14.8%	24.3%		51.7%	48.3%	8.1%
Urban	7,331	3,747	3,584	107	624	1,038	1,744	5,007	2,548	2,459	555
	20.3%	51.1%	48.9%	1.5%	8.5%	14.2%	23.8%	20.6%	50.9%	49.1%	7.6%
Rural	28,754	14,812	13,942	401	2,434	4,296	7,032	19,261	9,999	9,262	2,362
	79.7%	51.5%	48.5%	1.4%	8.5%	14.9%	24.5%	79.4%	51.9%	48.1%	8.2%

Prej këtyre statistikave mund të konfirmohet se komuna e Kamenicës është një komunë kryesisht rurale.

Në fund të vitit 2013, në komunën e Kamenicës funksiononin 2,072 biznese, prej tyre 1,828 biznese në pronësi të meshkujve, kurse 244 në pronësi të femrave.

Nr	Nacionaliteti	Numri i Bizneseve	Meshkuj	Femra
1.	Shqiptarë	902		
2.	Serbë	97		
3.	Romë	7		
4.	Anglez	1		
5.	Kinez	1		
Gjithsej			913	95
Totali			1008	

Edhe pse Komunitat e Kosovës me ligjin për vetëqeverisjen lokale janë të obliguara që përveç regjistrimit dhe licensimit të bizneseve të krijojnë edhe politika dhe legjislacionin përcjellës për zhvillim ekonomik, Komuna e Kamenicës ende nuk ka të hartuar dhe as të miratuar asnjë Rregullore për Përkrahje të Bizneseve të cilat udhëhiqen nga femrat, nuk ka Strategji dhe as Plan Veprimi për bashkëpunim dhe përkrahje bizneseve, në ndërkohë që mos pasja e këtyre dokumenteve kaq të rëndësishme vlerësohet nga vete komuna e Kamenicës si një mungesë, pengesë dhe problem që kërkon zgjidhje.

Hartimi dhe miratimi i Strategjisë komunale për përkrahje të bizneseve, gruas afariste në veçanti, me përfshirjen e drejtpërdrejtë të zyrtarëve komunal, bizneseve dhe grupeve tjera të interesit do të krijojë parakushte për përfshirje dhe pjesëmarrje në krijimin e politikave, procedurave dhe praktikave më të mira në përkrahje bizneseve në përgjithësi, dhe atyre të grave në veçanti. Strategjia do të ndihmojë Komunën dhe Drejtorinë Komunale për Zhvillim Ekonomik në planifikimin e integruar të politikave lokale

me ato nacionale, që prekin interesat e grave afariste në shumë sektorë të veçantë ekonomik. Bazuar në raportet dhe studimet e bëra nga organizata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, del në pah se pozita ekonomike e gruas në Kosovë nuk është aq e favorshme.

Sipas të dhënave nga regjistrimi i vitit 2011, në Kosovë ishin të punësuar 278,572 persona, prej tyre 213,076 meshkuj ose 76.5% dhe 65,496 femra ose 23.5%. Në komunën e Kamenicës ishin të punësuar gjithsej 5,022 persona, ose 1.8% e numrit të të punësuarëve në nivel vendi, prej tyre 4,179 meshkuj ose 83.2% dhe vetëm 843 femra ose 16.8%.

Po sipas të dhënave nga regjistrimi i vitit 2011, në Kosovë ishin të papunë 226,634 persona, prej tyre 144,911 meshkuj ose 63.9% dhe 81,723 femra ose 36.1%. Në komunën e Kamenicës ishin të papunë gjithsej 4,842 persona, ose 2.1% e numrit të të papunëve në nivel vendi, prej tyre 2,846 meshkuj ose 58.8% dhe vetëm 1,996 femra ose 41.2%.

Pra siç po shihet nga këto statistika, gjendja e numrit të të punësuarëve femra në komunë është edhe më e keqe se sa në nivel qendror ku afërsisht për çdo katër meshkuj të punësuar kemi një femër të punësuar. E njëjta statistikë negative paraqitet edhe te të papunët. Numri i femrave të papuna është për 5% më i lartë se sa ai në nivel qendror.

Pra, femrat janë edhe më pak të punësuar se sa meshkujt, e edhe nga aspekti i pronësisë së bizneseve.

3. STRATEGJIA PËR FEMRAT NDËRMARRËSE NË KOMUNËN E KAMENICËS PËR PERIU DHËN 2017-2022

Qëndrimet patriarkale të burrave, por edhe të grave në Kosovë, ende paraqesin një pengesë të konsiderueshme për zhvillimin e ndërmarrësisë së femrave në Kosovë. Krijimi i kushteve për zhvillimin e ndërmarrësisë, sidomos të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme do të jetë njëri nga prioritetet kryesore në Kosovë.

Pengesa më e madhe në zhvillimin e ndërmarrësisë së femrës ka të bëjë me disa vlera që janë rezultat i trashëgimisë shekullore kulturore. Poashtu, për femrën konsiderohet që është shumë e vështirë të mbajë "dy punë" njërën për të ushtruar profesionin e tij dhe të dytën-familjen. Për femrën gjithmonë është konsideruar se është e përshtatshme për disa profesione, kurse nuk është e përshtatshme për disa profesione tjera, psh.për femrën është shumë e përshtatshme që të merret me profesionet e shërbimeve dhe në arsim.

Për femrën është e vështirë që të marrë kredi në bankë për shkak se shumica e tyre nuk kanë pronësi pothuajse asgjë në emër të vet, prandaj nuk mund të kenë qasje në resurse financiare. Kjo pengesë është sidomos e theksuar me rastin e fillimit të biznesit të ri. Një pengesë shtesë është prania e ekonomisë jo-formale e cila e cenon tregun e punës.

Një pengesë shtesë është mungesa e trajnimeve dhe programeve edukative të cilat do të shtynin femrat që idetë dhe dëshirat e tyre t'i kthejnë në aktivitete konkrete të biznesit.

Poashtu, edhe nëse ekziston përkrahja ndaj femrave, ajo është e diferencuar në varësi të lokacionit, ku më tepër përkrahen femrat në vendbanimet urbane se sa ato në vendbanimet rurale.

Strategjia e zhvillimit të ndërmarrësisë së femrave ka për qëllim krijimin e kushteve dhe ambientit të përshtatshëm për hapjen e bizneseve të reja dhe rritjen e zhvillimitin e atyre ekzistuese , që gjithsesi do të kontribuonte në zvogëlimin e papunësisë në këtë komunë.

Rezultatet kryesore të cilat duhet të realizohen brenda kornizës së strategjisë deri në vitin 2022 janë:

1. Rritja e aktivitetit të ndërmarrësisë së femrave për ta arritur nivelin kombëtar.
2. Përkrahja e femrave për t'u bërë ndërmarrëse (femra në biznes)
3. Përkrahja e femrave për të vazhduar që të jenë të suksesshme (për ato që janë tashmë në biznes).
4. Përkrahja e femrave në biznes për t'u rritëzuar në nivelin lokal dhe kombëtar.

Arritjes së këtyre rezultateve komuna e Kamenicës do t'u qaset përmes këtyre veprimeve strategjike:

- 1. Krijimi i ambientit të volitshëm për zhvillimin e ndërmarrësisë së femrave**
- 2. Qasja më e mirë ndaj financave**
- 3. Krijimi dhe ofrimi i njohurive të nevojshme, dhe**
- 4. Rrjetëzimi i femrave në biznes**

1. Krijimi i ambientit të volitshëm për zhvillimin e ndërmarrësisë së femrave

Përmes këtij veprimi strategjik, komuna do të përmirësojë ambientin e të bërit biznes në komunë në pajtueshmëri të plotë me nevojat dhe kapacitetet e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që janë në kuadër të komunës.

Me qëllim të sigurimit të përkrahjes së nevojshme për ndërmarrësinë e femrave duhet të realizohen këto masa:

Masa 1 - Vendosja e një strukture/organi i në nivel të drejtorive komunale për koordinimin dhe implementimin e Strategjisë së ndërmarrësisë së femrave

Masa 2 - Rritja e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve konsulente për femrat në të gjitha fazat e veprimtarive të tyre afariste, duke nisur nga faza para themelimit të biznesit

Masa 3 - Aplikimi i diskriminimit pozitiv për të gjitha programet zhvillimore dhe ndarjet e granteve

Masa 4 - Promovimi i ndërmarrësisë dhe realizimi i programeve të dedikuara për vetëpunësim të grave dhe themelimin e bizneseve të reja

Masa 5 – Promovimi i bizneseve ekzistuese përmes përkrahjes së projekteve të femrave

Masa 6 - Hulumtimi për/dhe themelimi i inkubatorit të biznesit

Masa 7- Ofrimi i përkrahjes financiare dhe organizative për zhvillimin e veprimtarive të zanateve tradicionale të femrave.

Masa 8 - Lehtësimi i procedurave administrative duke eliminuar kërkesat për dokumentacion si dhe zvogëlimin e shpenzimeve

Masa 9 - Verifikimi i lartësisë dhe arsyeshmërisë së taksave për bizneset, me theks të veçantë për bizneset në pronësi apo bashkëpronësi të femrave.

Masa 10 - Hapja e një punëtorie për fruta të maleve dhe bimëve shëruese, pasiqë komuna e Kamenicës ka potencial me anë të një partneriteti publiko-privat,

Masa 11 - Rifunksionalizimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të serrave për kultivimin e perimeve dhe kultivimin e luleve

Masa 12 – Organizimi i panairëve për promovimin e punës së grave

2. Qasja më e mirë ndaj financave

Edhe pse ndërmarrjet e vogla dhe të mesme kryesisht e financojnë veten për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, prapëseprapë ato kanë nevojë të caktuara për financim nga burime të jashtme. Dhe kur vjen çështja për t'u financuar, burimi kryesor për financimin e jashtëm të këtyre ndërmarrjeve është sektori bankar. Me rastin e aplikimit për kredi pjesë e pandashme është kërkesa për hipotekë, përkatësisht për kolateral. Këtu fillojnë pengesat e mëdha për biznesin në pronësi të femrës, për shkak se zakonisht femra nuk ka pronë në emër të vet, dhe rrjedhimisht refuzohet si kërkesë nga banka. Edhe pse zgjidhja e çështjes së trajtimit të pronësisë nga ana e femrave është çështje që kryesisht duhet të trajtohet dhe zgjidhet në plan kombëtar, edhe komunat e kanë rolin e tyre.

Poashtu bankat zakonisht nuk i përkrahin bizneset fillestare për shkak të mungesës së historisë paraprake të biznesit, kështuqë është shumë e vështirë për një person, e sidomos për një femër që të hapë një biznes të ri për shkak se i mungojnë mjetet financiare.

Me qëllim të qasjes në financim nga ana e femrave ndërmarrëse, duhet të realizohen këto masa:

Masa 1 - Krijimi dhe promovimi i një fondi për grante për femrat fillestare në biznes në komunë

Masa 2 – Përdorimi i kodit të bashkëfinancimit të komunës në projekte nga donatorë të ndryshëm. Ky kod ekziston dhe me një përqindje të caktuar mund të bashkëfinancojë edhe komuna në përkrahjen e grave ndërmarrëse.

Masa 3 - Bashkëpunimi me Fondin e garantimit të kredive të krijuar në nivel qendror me qëllim përkrahjen e femrave fillestare në biznes

Masa 4 - Promovimi i kërkesave specifike të femrave ndërmarrëse në kuadër të bashkëpunimit me sektorin bankar me qëllim të gjetjes së modaliteteve për përkrahjen nga ana e bankave të femrave ndërmarrëse.

3. Krijimi dhe ofrimi i njohurive të nevojshme

Në të gjitha hulumtimet që janë bërë në Kosovë në fushën e aftësimin profesional dhe aftësive për bërjen e biznesit, është thënë se përkundër papunësisë së madhe që është në vend, ka një mungesë të theksuar prë kuadro të përgatitura profesionalisht. Kjo mund të thuhet edhe për pronarët e bizneseve, e sidomos

për ata që duan ta fillojnë një biznes të ri. Kjo është edhe më shumë e theksuar te femrat. Arsyeja kryesore për atë që anglisht quhet skills gap (zbrazëtirë shkathtësish) qëndron te sistemi shkollor në Kosovë. Realisht, sistemi i arsimit në Kosovë nuk është fare në pajtim me kërkesat e ekonomisë, duke prodhuar kuadro në sektorët që nuk janë të nevojshëm, kurse duke mos pasur programe dhe edukim për sektorët deficitarë. Për këtë qëllim duhet bërë një reformë adekuate në arsim dhe një koordinim adekuat të sistemit të arsimit me nevojat afatshkurta dhe afatgjata të ekonomisë së Kosovës. Kjo nuk është në kompetencat e organeve komunale por dikastereve përkatëse qeveritare.

Ajo çka mund të bëjë komuna është ofrimi i përkrahjes përmes ofrimit të këshillave apo trajnimeve në fillim dhe në vitet e para të zhvillimit të biznesit të tyre, me theks të veçantë te bizneset e femrave.

Me qëllim të arritjes të njohurive dhe shkathtësive të caktuara për femrat në biznes duhet të merren këto masa:

Masa 1 – Përgatitja dhe organizimi i programeve specifike të trajnimeve në bashkëpunim me qendrën regjionale të trajnimeve në Kamenicë

Masa 2 – Përgatitja e programeve të posaçme të mentorimit dhe këshillimit për përkrahje të femrave në biznes në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre dhe në bashkëpunim me ministrinë përkatëse

Masa 3.- Krijimi i qendrës për përkrahje të bizneseve në kuadër të komunës, njëra nga funksionet bazë të saj do të ishte përkrahja e femrave në biznes.

4. Rrjetëzimi (Networking) i femrave në biznes

Promovimi i ndërmarrësisë së femrave, përkatësisht i femrave në biznes duhet të jetë njëri nga prioritetet kryesore në nivel komunal. Duhet të ndryshojë koncepti dhe të kuptuarit të rolit të femrës në biznes, mundësitë e tyre për biznes dhe promovimi i tyre si një bazë shumë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik komunal.

Prandaj, kërkohet që femrat në biznes të bashkohen në rrjete formale apo joformale me qëllim të avokimit të interesave të tyre. Komuna duhet të luajë rolin kyç në përkrahjen e nismave të tilla.

Gratë në biznes, sipërmarrëse dhe menaxhere gjithnjë e më tepër janë duke e kuptuar rolin dhe nevojën për krijimin e rrjeteve të tyre për një bashkëpunim sa më të ngushtë. Përderisa meshkujt kryesisht marrëveshjet e tyre biznesore dhe bashkëpunimin e realizojnë në takime joformale, shpeshherë nëpër kafene, femrat më tepër preferojnë që t'i realizojnë këto qëllime përmes organizimit në grupe të ndryshme formale apo joformale.

Me qëllim të promovimit të lidhjeve afariste në mes të femrave ndërmarrëse, është e nevojshme që të realizohen këto masa:

Masa 1 – Organizimi i kampanjës së vazhdueshme për promovimin e ndërmarrësisë së femrave në komunë , fushata vetedijesuese per rendesinë e vlerave historike dhe ushqimeve tradicionale ne menyre qe te terhiqen turiste

Masa 2 - Rritja e kapacitetit të organizatave apo grupeve informale të biznesit të grave, me qëllim të forcimit të rrjetit dhe nxitjen e bashkëpunimit të ndërsjellë të ndërmarrësve në nivel komunal, por poashtu edhe për të forcuar bashkëpunimin e grave sipërmarrëse me shoqatat e tjera dhe bizneset e tjera jashtë komunës

Masa 3 – Promovimi i aktiviteteve apo bizneseve që nuk konsiderohet të jenë tipike për femrat

Masa 4 – Futja në skemën buxhetore dhënja e çmimit për gratë e suksesshme në biznes në komunë

Masa 5 – Krijimi i bazës së të dhënave për femrat në biznes në kuadër të komunës, si dhe përkrahja e shoqatave për të mbajtur evidencën dhe krijuar modelin e anëtarësimit për anëtarët e veta

Masa 6 – Vendosja e komunikimit direkt, dialogut dhe bashkëpunimit të përhershëm në mes të komunës dhe shoqatave të grave, apo rrjeteve të tyre formale apo informale me qëllim të vendosjes dhe realizimit të interesave të femrave ndërmarrëse

Masa 7 – Vendosja komunikimit direkt, dialogut dhe bashkëpunimit të përhershëm në mes të institucioneve të arsimit në komunë dhe shoqatave të grave ndërmarrëse

4. MATJA E REZULTATEVE KRYESORE TË STRATEGJISË

Rezultatet kryesore të cilat duhet të realizohen brenda kornizës së strategjisë deri në vitin 2022 janë:

Strategjia 1. Rritja e aktivitetit të ndërmarrësisë së femrave për ta arritur nivelin kombëtar.

Rezultati 1. Matet përmes Indeksit të aktivitetit gjithëpërfshirës ndërmarrës (Total Entrepreneurial Activity Index)

Strategjia 2. Përkrahja e femrave për t'u bërë ndërmarrëse (femra në biznes)

Rezultati 2. Matet përmes rritjes së numrit ndërmarrjeve të reja të themeluara nga ana e femrave

Strategjia 3. Përkrahja e femrave për të vazhduar që të jenë të suksesshme (për ato që janë tashmë në biznes).

Rezultati 3.1. Matet përmes rritjes së numrit ndërmarrjeve me pronare femra që vazhdojnë të operojnë në vitin 2 dhe 3 pas themelimit të tyre si ndërmarrje të reja

Rezultati 3.2. Matet përmes rritjes së numrit ndërmarrjeve me pronare femra që kanë rritje të vazhdueshme

Strategjia 4. Përkrahja e femrave në biznes për t'u rrjetëzuar në nivelin lokal dhe kombëtar.

Rezultati 4. Matet përmes numrit të anëtareve në shoqata apo rrjete formale e joformale komunale, regjionale apo kombëtare